



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

| | | | |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|
| Pranuar - Primijeno Më/Dana <u>29.05.2015</u> | | | |
| Nr. l organit Org. broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| | <u>01-013/743</u> | | |

Në bazë të nenit 12,2 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe nenit 36.2 pika d, të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2015, aprovon këtë:

R R E G U L L O R E PËR MËNYRAT PROCEDURAT DHE KUSHTET E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESET E VENDIMMARRJES

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregullore është inspirimi, shtytja dhe përfshirja aktive e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, ngritja e përgjegjësive të organeve, drejtorive dhe shërbimeve të Komunës për sigurimin e kushteve për deklarim të qytetarëve dhe përfillja e ideve, propozimeve dhe iniciativave të qytetarëve që të jenë me ndikim në ngritjen e profesionalizmit dhe avancimin e punëve dhe transparencën e plotë në ushtrimin e kompetencave në kuadër të nivelit lokal si dhe ngritja e besueshmërisë në raport Komunë dhe qytetarë.

Neni 2

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat, procedurat dhe kushtet e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, kategorive të veçanta të qytetarëve dhe grupeve të caktuara të interesit në proceset e vendimmarrjes, planifikimeve dhe përgjegjësive të Komunës në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimtarive kushtetuese dhe ligjore të nivelit lokal, përkatësisht të organeve dhe institucioneve të Komunës së Vitisë, në tekstin e mëtejme "Komuna".

Neni 3

Mbështetur në dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje, Komuna është përgjegjëse për afirmimin dhe avancimin e parimeve, kushteve, procedurave dhe mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për çështje të rëndësishme

së veçantë, konsultim paraprak me qytetarë, shoqata joqeveritare dhe grupe të interesit dhe për kontakt të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe subjekteve tjera me përfaqësuesit e organeve përkatëse të Komunës.

Neni 4

Organet kompetente të Komunës janë përgjegjëse për identifikimin dhe zbatimin e mënyrave dhe formave për ngritjen e interesimit të qytetarëve për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje dhe për krijimin e raporteve të partneritetit dhe ndarjen e përgjegjësisë, në relacion qytetarë, subjekte të ndryshme dhe organe përkatëse të Komunës për çështje të cilat propozohen për shqyrtim dhe pas miratimit në Kuvend të Komunës për zbatimin e tyre.

Neni 5

Komuna, në procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, siguron të gjitha informacionet, të dhënat, materialet dhe ofron ndihmë profesionale për çështje në interes për qytetarë.

Neni 6

Për kategori të qytetarëve me nevoja të veçanta, Komuna siguron kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme për pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.

Neni 7

7.1 Komunitetet pakicë, pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes e bëjnë në gjuhën e vet amtare.

7.2 Komuna i siguron në gjuhët e komuniteteve pakicë materialet e nevojshme dhe sipas nevojës edhe përkthimet simultane.

Neni 8

Organet dhe institucionet e Komunës, kujdesen që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të barabarta, përkatësisht të gëzojnë të drejtën e përfshirjes dhe deklarimit në proceset e vendimmarrjes pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër.

Neni 9

Konsultimet dhe takimet me qytetarë nuk mbahen në ditët festive shtetërore, ditët e festave të Komunës dhe ditët e festave fetare të komunitetit shumicë dhe komuniteteve pakicë.

Neni 10

Puna dhe aktivitetet e të gjitha organeve të Komunës janë publike dhe transparente, përveç rasteve të caktuara shprehimisht me dispozita ligjore apo me ndonjë akt tjetër nënligjor.

II. Mbledhjet e Kuvendit dhe trupave punues të Kuvendit

Neni 11

Mbledhjet e Kuvendit, Komiteteve të përhershme, Komiteteve të lëmive përkatëse, Komisioneve ad hoc dhe trupave tjerë punues të Kuvendit janë të hapura për qytetarë, shoqata joqeveritare, subjekte të interesuara dhe mjete të informimit publik.

Neni 12

Në kërkesë të qytetarëve, ndonjë subjekti apo përfaqësuesve të mjeteve të informimit mund të bëhet audio apo video transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjes së Kuvendit përkatësisht mbledhjes të trupit punues të Kuvendit.

Neni 13

Kuvendi dhe trupat punues, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, varësisht nga çështja e cila shqyrtohet, mund të mbajnë mbledhje të mbyllur apo vetëm një pjesë të mbledhjes.

Neni 14

14.1 Për kufizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në takime, Kuvendi apo trupi punues përkatës i Kuvendit, publikisht i informon qytetarët për bazueshmërinë ligjore dhe arsyeshmërinë e marrjes së një vendimi të atillë.

14.2 Informimi publik nga paragrafi paraprak i këtij neni bëhet së paku tri ditë para ditës për të cilën është caktuar mbledhja përkatëse.

III. Format e pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes

Mbledhjet e rregullta me qytetarë

Neni 15

15.1 Komuna, në çdo vit fiskal, është e obliguar t'i mbajë së paku dy takime me qytetarë dhe atë një mbledhje në gjashtëmujorin e parë dhe një mbledhje në gjashtëmujorin e dytë.

15.2 Komuna, sipas nevojës, mbanë edhe mbledhje të tjera me qytetarë, por në interval kohor së paku tre muaj nga mbledhja paraprake.

Neni 16

Mbledhjet me qytetarë i thërret dhe i kryeson Kryetari i Komunës. Në mungesë të Kryetarit të Komunës, mbledhjet me qytetarë i thërret dhe i kryeson nënkryetari i Komunës apo zyrtari të cilin e autorizon Kryetari i Komunës.

Neni 17

17.1 Thirrja dhe informimi për mbledhje me qytetarë bëhet së paku dy javë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

17.2 Në thirrje shënohen dita, data, koha e fillimit, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës, zyra ku mund të merren materialet, emrat dhe mbiemrat si dhe numrat e telefonave të zyrtarëve ku merren informacione dhe të dhëna shtesë për çështje të cilat kanë të bëjnë me mbledhjen përkatëse.

Neni 18

Kryesuesi i mbledhjes, varësisht nga çështja e cila shqyrtohet, e cakton kohëzgjatjen e diskutimeve dhe replikave si dhe kujdeset për mbarëvajtjen e gjithmbarshme të mbledhjes.

Neni 19

Për çdo çështje në kuadër të rendit të ditës paraprakisht jepet fjala hyrëse nga përfaqësuesi i organit, drejtorisë apo shërbimit kompetent të Komunës.

Neni 20

20.1 Kryesuesi fjalën ua jep pjesëmarrëseve sipas radhës së paraqitjes për diskutim .

20.2 Pjesëmarrësit për diskutim mund të paraqiten edhe para fillimit të mbledhjes.

20.3 Evidencën e radhës së paraqitjes për diskutim e mbanë zyrtari i caktuar nga Kryesuesi i takimit.

Neni 21

21.1 Në mbledhje askush nuk mund të flasë pa e kërkuar përkatësisht pa ju dhënë fjala nga kryesuesi.

21.2 Në kuadër të një pike të rendit të ditës, pjesëmarrësve në mbledhje, në parim u lejohe të diskutojnë vetëm një herë.

21.3 Diskutimi për herë të dytë në kuadër të një pike të rendit të ditës lejohe vetëm pas përfundimit të diskutimeve të të gjithë të paraqiturve për diskutim dhe atë në kohëzgjatje në gjysmën e kohës të caktuar për diskutimin e parë.

Neni 22

- 22.1 Në rast se gjatë debatit përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë emri i ndonjë diskutuesi, apo shprehet mospajtim me ndonjë diskutim ose pjesë të diskutimit të ndonjë parafolësi, është e lejuar replika.
- 22.2 Replika ndaj replikës është e lejuar.
- 22.3 Replika vijuese nuk është e lejuar, përveç rasteve nëse kryesuesi e vlerëson të arsyeshme dhe të njëjtën e lejon.

Neni 23

Përfaqësuesit e organeve, drejtorive dhe shërbimeve të Komunës, për çështjet e shtruara gjatë debatit, sqarimet plotësuese i paraqesin pas përfundimit të diskutimeve të të gjithë të paraqiturve për diskutim.

Neni 24

Në fund të debatit çështjet e shqyrtuara të rendit të ditës, kryesuesi i përfundon me rezyme të shkurtë dhe konstatime mbi bazën e diskutimeve të zhvilluara.

Neni 25

Pjesëmarrësit në mbledhje me qytetarë gjatë diskutimeve janë të obliguar t'i përmbahen çështjes e cila është për shqyrtim në kuadër të pikës së rendit të ditës dhe të respektojnë dinjitetin dhe autoritetin e të pranishmëve dhe të personave të tjerë që ndërlidhen me çështjen e cila debatohet.

Neni 26

- 26.1 Pjesëmarrësit në mbledhje, përkatësisht përfaqësuesit e organeve, drejtorive dhe shërbimeve të Komunës, qytetarët dhe subjektet tjerë janë të obliguara të mos ndërhyjnë derisa ndonjë pjesëmarrës është duke diskutuar.
- 26.2 Gjatë debatit, nuk janë të lejuara shprehjet ofenduese, nënçmuese si dhe paraqitja e të dhënave nga jeta private e askujt.

Neni 27

- 27.1 Në mbledhje me qytetarë, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, pjesëmarrësit e kanë të drejtën për të shtruar pyetje në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimtarive të Komunës.
- 27.2 Kryesuesi apo përfaqësuesit e organeve, drejtorive dhe shërbimeve kompetente të Komunës japin përgjigje në pyetjet e shtruara.
- 27.3 Në rast se, për përgjigje kërkohen të dhëna konkrete, të cilat nuk mund të sigurohen gjatë mbajtjes së mbledhjes, ose kur qytetari nuk është i kënaqur me përgjigjen e dhënë dhe me përgjigje shtesë, përgjigjet jepen në formë të shkruar në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

27.4 Qytetarët dhe subjektet tjera mund të kërkojnë që në pyetjen e shtruar përgjigjja t'iu jepet në formë të shkruar.

27.5 Organi apo Drejtoria kompetente është e obliguar që parashtruesit të kërkesës t'ia dërgojë përgjigjen në formën e shkruar në afatin prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

Neni 28

28.1 Respektimi i rregullave për mbarëvajtjen e mbledhjes me qytetarë vlenë për të gjithë pjesëmarrësit.

28.2 Në rast se ndonjë prej të pranishmëve nuk iu përmbahet rregullave të përcaktuara, kryesuesi sipas vlerësimit të rastit, mund të shqiptojë masat dhe atë tërheqje e vërejtjes, marrja e fjalës dhe largim nga mbledhja.

28.3 Masa e shqiptuar e largimit vlen vetëm për mbledhjen përkatëse.

Neni 29

Në mbledhje me qytetarë janë të obliguar të marrin pjesë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, varësisht nga çështjet të cilat shqyrtohen, edhe anëtarët e Komitetit të lëmisë përkatëse si dhe përfaqësuesit e organeve, drejtorive dhe shërbimeve relevante të Komunës.

Neni 30

30.1 Në mbledhje me qytetarë mbahet procesverbali.

30.2 Mbi bazën e procesverbalit nxirret Ekstrakti i procesverbalit i cili përmban datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, kohën e fillimit, emrin, mbiemrin dhe funksionin e udhëheqësit apo kryesuesit të mbledhjes, pjesëmarrësit, pikat e rendit të ditës, esenca e shkurt e diskutimeve me konstatimet përkatëse dhe kohën e mbarimit të mbledhjes.

Neni 31

31.1 Pjesëmarrësi në mbledhje ka të drejtë të kërkojë që, diskutimi i tij apo një pjesë e diskutimit, në ekstraktin e procesverbalit të evidentohet në formë të shkurtë në mënyrën në të cilën ai e paraqet çështjen konkrete.

31.2 Për plotësimin e kërkesës sipas paragrafit paraprak të këtij neni, pjesëmarrësi në mbledhje diskutimin e dorëzon në formë të shkruar.

Neni 32

Lista e nënshkruar e pjesëmarrësve në mbledhje është pjesë përbërëse e ekstraktit të procesverbalit.

Neni 34

Ekstraktin e procesverbalit, pas miratimit, e nënshkruan udhëheqësi apo kryesuesi i mbledhjes.

IV. Mënyrat e pjesëmarrjes të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes

Diskutimet publike

Neni 35

35.1 Kuvendi i Komunës, propozimet e akteve të përgjithshme, akteve dhe çështjeve të tjera të parapara me dispozita ligjore, Statut apo ndonjë akt tjetër normativ të Komunës, me Vendim të veçantë i vë në diskutim publik.

Çështjet e obliguara për diskutim publik janë:

- a) Statuti i Komunës
- b) Strategjia e zhvillimit ekonomik
- c) Plani zhvillimor komunal
- d) Plani zhvillimor urban
- e) Plani rregullues urban
- f) Plani për mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit
- g) Transporti publik
- h) Furnizimi me ujë të pijes
- i) Rregulloret dhe vendimet me të cilat përcaktohen të drejtat dhe obligimet e qytetarëve,
- j) Bashkëfinancimi për realizimin e projekteve të ndryshme
- k) Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit në lagje apo lokalitete të caktuara
- l) Krijimi i kushteve më të volitshme për rekreacion të qytetarëve në përgjithësi dhe rinisë në veçanti
- m) Çështje tjera të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë janë me ndikim në kushtet jetësore të qytetarëve
- n) Çështje tjera të përcaktuara me Statutin e Komunës, dhe
- o) Çështje për të cilat vendos Kuvendi i Komunës.

35.2 Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç tjerash, përmban emërtimin e drejtorisë apo shërbimit që e zbaton diskutimin publik, kohëzgjatjen e diskutimit publik, vendin, kohën e mbajtjes së debatit publik dhe mënyrat tjera të pjesëmarrjes në diskutim publik të parapara me këtë Rregullore.

Neni 36

Në funksion të efikasitetit dhe racionalitetit diskutimet publike mund të mbahen në disa vende të nënjesive territoriale të Komunës.

Neni 37

Kohëzgjatja e diskutimit publik është:

- Për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, 30 ditë
- Për propozim buxhetin e Komunës, 30 ditë
- Për planet zhvillimore dhe urbanistike, 60 ditë

Për aktet e çështje të tjera , 15 ditë

Neni 38

Pas përfundimit të diskutimit publik hartohet raporti i cili përmban rezymenë e propozimeve dhe sugjerimeve të paraqitura gjatë diskutimit publik, arsyeshmërinë për pranimin apo mospranimin e propozimeve dhe sugjerimeve konkrete dhe çështjet e ndryshuara të aktit të propozuar mbi bazën e diskutimit publik.

Diskutimet publike profesionale

Neni 39

Për çështje të caktuara për dhënien e vlerësimeve në aktet e propozuara nga ana e qytetarëve profesionist dhe shoqatave të lëmive përkatëse organizohen diskutime publike profesionale.

Deklarimet paraprake

Neni 40

40.1 Deklarimet paraprake për nevojat e qytetarëve bëhen 60 ditë para ditës së planifikuar për miratimin e aktit përkatës.

40.2 Qytetarët dhe subjektet e interesuara në afatin e përcaktuar i dërgojnë propozimet e tyre Drejtorisë apo shërbimit kompetent.

40.3 Drejtoria apo shërbimi kompetent, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha propozimeve dhe sugjerimeve e përgatitë propozimin e aktit përkatës dhe e procedon në procedurën e rregullt për miratimin e të njëjtit.

Referendumi

Neni 41

41.1 Për çështje në interes të përgjithshëm për qytetarë dhe Komunë mund të organizohet referendumi.

41.2 Mënyra e organizimit dhe mbajtjes së referendumit përcaktohet me Statutin e Komunës.

Organizimi i punëtorive

Neni 42

42.1 Punëtoritë organizohen për shqyrtim profesional të qytetarëve lidhur me shqyrtimin e akteve të propozuara dhe çështjeve tjera në interes të drejtpërdrejtë për plotësimin e nevojave të qytetarëve.

42.2 Puna dhe aktiviteti i punëtorive zhvillohet përmes Organizatave joqeveritare dhe ekspertëve të lëmive përkatëse.

Peticioni

Neni 43

43.1 Me peticion, grupi i qytetarëve i drejtohet organeve kompetente të Komunës, në radhë të parë organeve përfaqësuese dhe drejtorive apo shërbimeve përkatëse, për miratimin e ndonjë akti të përgjithshëm, zgjidhjen e çështjeve të caktuara apo ndërmarrjen e veprimeve konkrete në interes për Komunë në përgjithësi dhe qytetarë në veçanti.

43.2 Mënyra e parashtrimit dhe vendosjes të peticionit më afërsisht përcaktohet me Statutin e Komunës.

Dhënia e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve në formë të shkruar

Neni 44

Në aktet e propozuara vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet në parim paraqiten ditën e mbajtjes të diskutimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten edhe gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik .

Iniciativa e qytetarëve

Neni 45

45.1 Me iniciativë qytetare iniciohet procedura për shqyrtimin e zgjidhjes së çështjeve në interes të banorëve të lagjeve, vendbanimeve përkatëse apo qytetarëve të Komunës në përgjithësi.

45.2 Organi kompetent i Komunës është i obliguar që në afat prej 30 ditësh, t'i njoftojë në formë të shkruar parashtruesit për qëndrimin e marrë lidhur me iniciativën qytetare.

45.3 Me statutin e Komunës më afërsisht caktohen çështjet për të cilat mund të shtrohet iniciativa qytetare, numri i nevojshëm i nënshkrimeve të qytetarëve dhe procedura për shqyrtimin dhe vendosjen e iniciativës qytetare.

Përcaktimi i nevojave të qytetarëve

Neni 46

Punët përgatitore për hartimin e propozimit të Planit zhvillimor komunal, Planit zhvillimor urban dhe Planit rregullues urban, propozimbuxhetit të Komunës, akteve të përgjithshme, dokumenteve dhe çështjeve të tjera i bëjnë organet, drejtoritë dhe shërbimet kompetente të Komunës mbi bazën e grumbullimit të të dhënave nga qytetarët, organizatat joqeveritare, grupet e interesit dhe subjektet tjera relevante.

Anketimi

Neni 47

47.1 Për hulumtimin e çështjeve të caktuara , varësisht nga lëmia, organi, drejtoria apo shërbimi kompetent i Komunës, përmes pyetjeve bënë anketimin për vlerësimin sa më real të çështjeve konkrete.

47.2 Analizën e materialit anketues, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, e bënë organi, drejtoria apo shërbimi, i cili e ka bërë anketimin dhe i njëjti e përgatitë propozimin përkatës dhe e procedon në procedurën e përcaktuar për miratim

Transparenca

Neni 48

Punët dhe aktivitetet e institucioneve të Komunës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë transparente për qytetarë, subjekte të interesuara dhe mjete të informimit.

Obligimet e Komunës

Neni 49

Në kuptim të dispozitave të kësaj Rregulloreje Komuna është e obliguar të:

- a) Sigurojë mjete të nevojshme buxhetore për afirmimin e parimeve dhe krijimin e kushteve për pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe subjekteve tjera në proceset e vendimmarrjes.
- b) Sigurojë ndihmë profesionale, materiale, të dhëna dhe informacione të nevojshme.
- c) Përcaktojë çështjet e obligueshme për diskutim publik.

Propozimi i prioriteteve dhe akteve tjera

Neni 50

Organet kompetente të Komunës, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi, janë të obliguara që mbi bazën e hulumtimeve, anketave, pyetësorëve dhe analizave përkatëse, pas zbatimit të diskutimit publik, Kuvendit të Komunës, t'i bëjnë propozimet e prioriteteve dhe akteve konkrete.

Informimi i qytetarëve

Neni 51

Qytetarët për të gjitha çështjet me interes njoftohen përmes ëeb faqes së Komunës, komunikatave zyrtare, mjeteve të shkruara dhe elektronike të informimit, buletineve të përkohshme dhe

buletineve vjetore, njoftimeve në tabelat e shpalljeve dhe njoftimet e drejtpërdrejta në organet kompetente.

V. Dispozitat përfundimtare

Neni 52

Zbatimin e Rregullores e bënë Kryetari i Komunës dhe organet vartëse.

Neni 53

Rregulloja hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Viti, 28 Maj 2015

Naim PIRA

Kryesues i Kuvendit të Komunës



Naim Pira